



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2020:014377

Datë: 06.10.2020

Numri i dokumentit: 01168579

P.nr.100/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit B. K. me vendbanim në N. komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit 2019:0004427 (PP.II.nr.130/20) të datës 22.01.2020, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë 25.08.2020, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit 2019:0004427 (PP.II.nr.130/20) të datës 22.01.2020, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: B. K. nga i ati R. i lindur më datë ... në fshatin N. Komuna Vushtrri, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., me shifren unike të konsumatorit DMI-34132, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën... në shtëpinë e tij në fshatin Novolan në Vushtrri, ka shfrytëzuar shërbime për të cilat e di se janë të disponueshme vetëm në këmbim të pagesës, dhe ju është shmangur pagesës, në atë mënyrë që pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar KEDS ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke u kyq direkt me kabllon në shtyllë, duke anashkaluar njëhisorin, në mënyrë të kundërligjshme e ka shpenzuar energjinë elektrike duke i shkaktuar KEDS-it të dëmit në vlerë prej **286.8 euro**, që është vërtetuar me vështrimin në terren në ditën e cekur nga ana e zyrtarëve të autorizuar të KEDS-it.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së**

Andaj, gjykata konformë dispozitave të neneve nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 314 par.1 të KPRK, dhe nenit 365, 450, 463 dhe 495 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

TË PANDEHURIT: B. K. i'a cakton **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej treqind euro (300 €), i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se e pandehuri nuk kryen veprë penale tjetër në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej 1 viti.

DETYROHET i pandehuri që palës së dëmtuar KEDS, të i'a paguaj në emër të dëmit të shkaktuar shumë prej 286.8 €.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 €. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën, 2019:0004427 (PP.II.nr.130/20) të datës 22.01.2020, kundër të pandehurit B. K. nga N. Komuna e Vushtrrisë, ku edhe tani jeton, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri B. K. , ligjvënësi ka parashikuar dënimi me gjobë ose dënim me burgim deri në tre (3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së, dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënie të urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Procesverbalin e datës 04.10.2019, Nr.0953731, Foto dokumentacioni (5) foto, fatura e dt. 15.10.2019, kalkulimi i rikthimit të humbjeve datë 15.10.2019, janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhërin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës KEDS, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënim në vështrim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpëron dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar KEDS gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.100 /20, datë 25.08.2020

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.